

AGENDA

NGJARJA

Program mësimorë në matjen e rezultateve të tregut të punës të pjesëmarrësve në kurset e AAP-së - zbatimi i studimeve gjurmuese

VENDI

Prizren (Hotel Theranda)

DATA

3 – 5 Maj 2017



Përmbledhje

Përputhja e arsimit dhe aftësimin për nevojat e tregut të punës është një prioritet kyç në Kosovë¹. Në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës (MASHT), ETF do të organizoj një program mësimor në matjen e rezultateve të tregut të punës të pjesëmarrësve në kurset të AAP-së, me fokus të veçantë në kryerjen e studimeve gjurmuese.

Objektivi kryesor është zgjerimi i njohurive teorike dhe praktike të pjesëmarrësve mbi metodat për të vlerësuar rëndësinë e kurseve të AAP-së për nevojat e tregut të punës. Një nga instrumentet kryesore për të kryer këtë vlerësim është studimi gjurmues. Trajnimi do të mbulojë çështjet strategjike për realizimin e studimeve gjurmuese (të tilla si objektivat, hartimin, përpunimin, analizimin dhe përdorimin e rezultateve për bërjen e politikave), njohuri praktike në zbatimin dhe futjen e softuerit QTAFI (mjet për administrimin automatik të anketës dhe mbledhjen e të dhënave). ETF do të lehtësojë shkëmbimin e përvojës me ekspertë nga vendet e tjera që janë në zbatim ose në testimin e studimeve gjurmuese në sistemet e tyre të arsimit dhe aftësimin.

¹ Ky përcaktim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Programi po ashtu do të përfshijë një pasqyrë të metodave dhe të dhënave të përdorura në hulumtimin për nevojën për shkathtësi dhe se si për të transferuar gjetjet në planifikimin dhe ofrimin e programeve trajnuese.

Informacion i përgjithshëm

Kosova përballlet me papunësinë e lartë të të rinjve dhe boshllëqet gjinore në tregun e punës. Përmirësimi aftësive, shkathtësive në tregun e punës është një element i rëndësishëm i çdo strategjie për të lehtësuar kalimin e të rinjve nga shkolla në punë apo për të rritur nivelin e punësimit të grupeve më pak të përfaqësuara në punësim. Qeveria e Kosovës ka prioritet cilësinë në AAP dhe tranzicionin nga shkolla në punë në mesin e angazhimeve të zotuarra në strategjitë kombëtare (p.sh. zhvillimi, edukimi, punësimi) si dhe në dialogun me Bashkimin Evropian (p.sh. Programit të Reformës Ekonomike; agjendën e reformave evropiane, prioritetet për financim IPA të BE-së).

ETF ka ofruar mbështetje për Kosovën në fushën e AAP-së, në përputhjen e shkathtësive dhe rritjen e punësimit gjatë viteve të fundit dhe do të vazhdojë mbështetjen e saj dhe këshillat për përmirësimin e relevancës së shkathtësive për tregun e punës.

Sigurimi i përgjegjshmërisë fillestare dhe të vazhdueshëm të AAP-së në tregun e punës mbështetet në informata të sakta dhe me kohë rreth kërkesës së shkathtësive dhe rezultateve të diplomuarve. Një mënyrë për të arritur këtë është të bëhen studime të rregullta gjurmuese (të njohura edhe si anketat pasuniversitare, anketat alumni, ose ndjekja e të diplomuar). Studimet gjurmuese janë analiza retrospektive të diplomuarve përmes një studimi të standardizuar që zhvillohet pas diplomimit (zakonisht midis 6 muaj dhe 3 vjet). Objektivi i përgjithshëm është për të vlerësuar ndikimin e programeve të arsimit të diplomuarve në tranzicionin në punësim dhe në karrierën e tyre. Më konkretisht, studimet gjurmuese mund të japin informacion për të përmirësuar përmbajtjen e arsimit dhe aftësimin dhe kushtet e studimit, duke shkurtuar kalimin e të diplomuarve nga arsimi në tregun e punës dhe përputhjen më të mirë të ofertës me kërkesën për shkathtësi.

Aktualisht, nuk ka studime të rregullta në rezultatet e punësimit të të diplomuarve të AAP-së në Kosovë. Në vitin 2016 ETF ka filluar të bashkëpunojë me ministrinë e arsimit dhe punësimit të Kosovës, me qëllim për të ngritur kapacitetin e institucioneve të AAP-së për të kryer studime të rregullta gjurmuese. Ngjarja e parë e mësimit u zhvillua në fund të vitit 2016, me pjesëmarrës punonjësit e Qendrave të Aftësimin Profesional (brenda strukturës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale). Përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencisë për AAP dhe arsimin e të rriturve. ETF do të vazhdojë këtë bashkëpunim edhe në vitin 2017, përmes organizimit të programit mësimor aktual dhe sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme për të kryer studime gjurmuese (këshilla, ushtrime, zhvillimi i materialeve metodologjike). Objektivi afatgjatë është që të ndihmojë autoritetet e Kosovës me vendosjen e studimeve të rregullta gjurmuese.

Programi mësimor

Programi mësimor është e ndërtuar mbi përvojën e ETF-së në vendet në tranzicion dhe zhvillim duke u fokusuar në hartimin praktik dhe zbatimin e studimit gjurmues dhe përdorimin e informacionit për hartimin e politikave. Programi do të përbëhet nga shkëmbime teorike dhe praktike të informacionit dhe prezantime të rasteve përkatëse të vendeve, ndërtuar mbi metodat interaktive të trajnimit që do të lejojnë pjesëmarrësit për të ndajnë përvojat dhe pikëpamjet e tyre.

Sa i përket rezultateve të mësimit, deri në fund të këtij programi, pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike në lidhje me:

- metodat dhe mjetet për parashikimin dhe përputhjen e shkathtësive;
- të dhënat dhe prodhimin e informatave, shpërndarjen dhe të përdorimin në arsim, trajnimin dhe promovimin e politikave të punësimit;
- fushëveprimi, dizajnimi, instrumentet dhe aspekte të zbatimit të studimeve gjurmuese;
- analiza e të dhënave, interpretimi dhe përdorimi i gjetjeve të studimit gjurmues në përshtatjen e programeve arsimore dhe trajnuese dhe politikave dhe programet tjera relevante.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të dinë më shumë për përvojat e ndryshme ndërkombëtare të përdorimit të studimeve gjurmuese.

Pjesëmarrësit e synuar

Pjesëmarrësit e synuara janë punonjësit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, Shkollat e AAP-së, Qendrat e Kompetencës dhe përfaqësues të organizatave të tjera aktive në fushën e zhvillimit të kapitalit njerëzor në Kosovë

Kjo do të sigurojë një bazë të mirë për ndër-fekondim dhe ndarjen e përvojës.

Veprimet përcjellëse

Ngjarja e prezantuar është e lidhur me një paketë më të gjerë të ekspertizës dhe mbështetjes që do të ofrohen nga ETF në periudhën e ardhshme me qëllim të përgatitjes së një metodologjie plotësisht të përshtatur gjurmuese dhe instrumentet që pasqyrojnë kushtet specifike dhe burimet e sistemit të AAP-së në Kosovë dhe profilin e të diplomuarve.

Pritet që homologët e Kosovës (Ministria e Arsimit, agjencitë e saj të specializuara të AAP-së dhe shkollat) do të ndjekin metodologjinë e studimit gjurmues për zbatim të rregullt.

DITA 1 - e mërkurë 3 maj

10:00 – 10:30	Mbërritja dhe regjistrimi i kandidatëve Kafe mirëseardhje
10.30 – 11.30	Sesioni i hapjes Mirëseardhje dhe hyrje në seminar, qëllimi dhe temat Valbona Fetiu Mjeku, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Ferit Idrizi Agjencia për Arsim dhe Aftësim Professional dhe Arsim për të Rritur Simona Rinaldi, Specialiste në Politikat dhe Sistemet e AAP-së – Menaxhere për Kosovë, Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF) Hyrje dhe pritjet nga programi mësimor Pjesëmarrësit e ngjarjes
11.30 – 13.00	Sesioni 1: Bërja e AAP-së relevante për nevojat e tregut të punës Konteksti dhe zhvillimet në Bashkimin Evropian dhe vendet partnere të ETF-së në parashikimin dhe përputhjen e shkathtësive - roli i studimeve gjurmuese Pjesëmarrësit e ngjarjes Cristina Mereuta, Specialiste e Tregut të Punës, ETF Reflektimi nga informacioni itregut të punës në ofrimin e udhëzimeve për karrierë në Kosovë. Të rejat në veprimet e LUX DEV për të konsoliduar funksionin e udhëzimit në karrierë në shkollat e AAP-së dhe Qendrave të Kompetencës Daniele Passalacqua, Këshilltar Teknik Udhëheqës, LUX DEV Cilat janë përvojat e mëparshme në monitorimin e tranzicionit nga shkolla në punë e të diplomuarve në Kosovë? Ndarja e përvojave dhe mësimave Pjesëmarrësit e ngjarjes
13:00 – 14:00	Dreka
14:00 – 15:15	Sesioni 2: Të dhënat dhe informacioni për vendimet e bazuara në prova të AAP-së - përdorimi i studimeve gjurmuese Ky sesion prezanton konceptin e studimeve gjurmuese dhe opsionet e ndryshme që ekzistojnë për të hartuar dhe zbatuar një gjurmim. Ajo gjithashtu tregon implikimet e opsioneve të ndryshme të projektimit në zbatim, dhe prezanton elementet kyçe që janë thelbësore për të kryer një studim gjurmues (pyetëtori, mjeti për mbledhjen e të dhënave, rolet institucionale etj) Martino Rubal Maseda, Zyrtar Statistikor, ETF
15:15 – 15:30	Pauzë për kafe
15:30 – 17:00	Sesioni 3: Zbatimi i studimeve gjurmuese dhe përdorimi i rezultateve në politikate arsimit dhe aftësimin Rast studimi: Estonia - zbatimi i studimeve të rregullta gjurmuese dhe përdorimi i rezultateve në politika Kaie Piiskop, Këshilltar, Qendra për Kurrikula dhe metodologji, Fondacioni Innove, Estoni Pyetje dhe përgjigje

DITA 2 – e martë 4 maj

09.00 – 10.30	<p>Sesioni 4: Rregullimi, planifikimi dhe zbatimi i studimeve të rregullta gjurmuese në Republikën e Moldavisë</p> <p><i>Rast studimi: Republika e Moldavisë - rregullorja e veçantë për zbatimin e studimeve të rregullta gjurmuese, aranzhimet praktike, përgjegjësitë dhe përdorimi i rezultateve</i></p> <p><i>Vera Chilari, konsulent ekspert, Ministria e Arsimit Kombëtar, Republika e Moldavisë</i></p> <p>Pyetje dhe përgjigje</p>
10.30 – 11.00	<p>Pauzë për kafe</p>
11.00 – 13.00	<p>Sesioni 5 - Pjesa 1: Zbatimi i studimeve gjurmuese: hapa praktike dhe mjetet</p> <p>Prezantim i detajuar në elemente kyçe për zbatimin e një studimi gjurmues: baza e të dhënave të adresave të të diplomuarve, kontaktimi i të diplomuarve dhe përkujtesat, detyrat e ekipit për zbatimin e studimeve gjurmuese, testimin, dhe norma përgjigjeve. Metodatat e ndryshme të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë një hyrje në QTAFI (një platformë online për të mbledhur përgjigjet e të diplomuarve)</p> <p>Pyetje dhe përgjigje</p> <p>Martino Rubal Maseda, Zyrtar Statistikor, ETF</p>
13:00 – 14:00	<p>Dreka</p>
14:00 – 16:30	<p>Sesioni 5 – Pjesa 2: Zbatimi i studimeve gjurmuese: hapa praktike dhe mjetet</p> <p>Ushtrime praktike</p> <p>Seanca praktike hulumton në një mënyrë praktike elementet kyçe për zbatimin e studimeve gjurmuese</p> <p>Martino Rubal Maseda, Zyrtar Statistikor, ETF</p>

DITA 3 – e premte 5 maj

09:30 – 11:00	<p>Sesioni 6: Zbatimi i studimeve gjurmuese në Kosovë, vendimet dhe planet për zbatim</p> <p>Rishikimi i rezultateve të ushtrimeve praktike</p> <p>Hapa konkret në të ardhmen për zbatimin praktik të studimeve gjurmuese në sistemin e AAP-së në Kosovë</p> <p>Identifikimi i vështirësive të mundshme ose rreziqet dhe zgjidhjet</p> <p>Diskutim lehtësuar nga MASHT, AAPARr dhe ETF</p>
11.00 – 11.30	Pauzë për kafe
11.30 – 12.30	<p>Përfundimet dhe vlerësimi i programit mësimor</p> <p>Shpërndarja e certifikatave të pjesëmarrjes</p> <p>Foto grupore</p>
12.30 – 14.00	Dreka
	<p>Mbyllja e ngjarjes</p> <p>Nisja e pjesëmarrësve</p>